

Filloi implementimit i Projektit
'Skema BEACON'

Praktikat më të mira komunale
në fushën e shërbimeve publike

AKK-ja
parandaloi
zvogëlimin e të hyrave
vetanake - përafërsisht
deri në 10 milion
euro



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Buletini

Publikim dymujor • Viti XII • Nr.70 • Janar - Shkurt 2015



Këshilli i Kryetarëve

Presidentja Atifete Jahjaga priti udhëheqjen e Asociacionit të Komunave të Kosovës

Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga, priti sot në takim Kryetarin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), z. Naim Ismajli dhe Drejtorin Ekzekutiv z. Sazan Ibrahim.

Kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli njoftoj Presidenten e vendit znj.Atifete Jahjaga me fushëveprimtarinë dhe aktivitetin e Asociacionit të Komunave të Kosovës si një organizatë që mbrohet dhe përfaqëson interesat e Komunave të Republikës së Kosovës. Presidentja Jahjaga e vlerësoi punën e Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe shprehu mbështetjen e saj për aktivitetet e këtij Asociacioni, që përfaqëson interesat dhe shqetësimet e të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Presidentja Jahjaga theksoi rëndësinë e bashkëveprimit dhe koordinimit ndër-institucional për të trajtuar të gjitha çështjet me interes për qytetarët e Kosovës, pa dallim. Poashtu Presidentja u shpreh për bashkëpunim dhe mirëpritje përfaqësimin e komunave nga ana e Asociacionit të Komunave të Kosovës në Këshillat Kombëtar pranë Presidencës së Kosovës. Presidentja Jahjaga mirëpriti prezencën e Asociacionit të Komunave të Kosovës në mekanizmat dhe rrjetet ndërkombëtare të autoriteteve lokale dhe poashtu afrimin e komunave të Kosovës me komunat nga Evropa si dhe kërkoi edhe më tej angazhim në fushën e integriteteve evropiane. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z. Naim Ismajli shprehu mirënjohjen për mbështetjen që gëzon ky Asociacion nga Presidentja e Republikës.





Këshilli i Kryetarëve

Nën organizim të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Këshilli i Kryetarëve ka mbajtur takimin e radhës ku përveç kryetarëve të komunave kanë marrë pjesë edhe ministri i Ministrisë së Financave z.Avdullah Hoti, ministri i Ministrisë së Shëndetësisë z.Imet Rrahmani, ministri i Ministrisë së Mirëqenies Sociale z.Arban Abrashi, Zëvendësministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal z.Bajram Gecaj, Sekretari i

Përgjithshëm i MAPL-së z.Besnik Osmani, Sekretari i Përhershëm i MASHT-it z.Xhavit Dakaj, nënkryetar të komunave dhe Drejtorët e pesë Agjensive Rajonale të Zhvillimit. Kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli duke paraqitur rendin e ditës tha se në këtë takim do të bëjmë përzgjedhjen (me short) të katër Kryetarëve të cilët do i përfaqësojnë Komunitat në

Komisionin e Granteve, pastaj do të përcaktohen prioritetet e AKK-së për programin legjislativ të Qeverisë së Kosovës (caktimi i kryetarëve nëpër Grupe Punuese) dhe do të bëhet caktimi i prioritetëve të komunave për investime nga Komisioni Evropian nëpër komuna në shtatë (7) vitet e ardhshme.

Në mbledhjen e Këshillit të Kryetarëve caktohet me short Komisioni i Granteve

Duke marrë fjalën në këtë takim, ministri i Financave z.Avdullah Hoti, njëherazi edhe Kryesuesi i Komisionit të Granteve, falenderoi Asociacionin e Komunave të Kosovës për organizimin e këtij takimi për caktimin e anëtarëve nga Komunitat në Komisionin e granteve. Ministri Hoti poashtu përgëzoi Kryetarët e Komunave për bashkëpunimin dhe kontributin në arritjen e objektivave dhe sukseseve gjatë vitit 2014, dhe i ftoj ata që ky trend i sukseseve të performoj në nivel më të lartë profesional dhe menaxherial gjatë vitit fiskal 2015. Ai gjithashtu shprehi përkushtimin e Ministrisë së Financave për një fillim të mbarë të punës së përbashkët në vitin 2015, për përmbushjen e prioritetëve strategjike qeveritare, avancimin e konceptit zhvillimor të buxhetit dhe



integrimin e strategjive zhvillimore komunale në funksion të arritjes së standardeve të synuara drejt integritit evropian. Me pas ish-anëtarët e Komisionit të Granteve bënë përzgjedhjen me short të anëtarëve të rinj në Komisionin e Granteve. Kështu

për anëtar të rinj të Komisionit të Granteve janë përzgjedhur kryetari i komunës së Mitrovicës, kryetari i komunës së Shtimes, kryetari i komunës së Kamenicës dhe kryetari i komunës së Parteshit.

Këshilli i Kryetarëve përcaktoi prioritetet e AKK-së në programin vjetor legjislativ të Qeverisë së Kosovës

Në pikën e dytë të rendit të ditës lidhur me përcaktimin e prioritetëve të AKK-së për programin legjislativ të Qeverisë së Kosovës (caktimi i kryetarëve nëpër Grupe Punuese), kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli tha se përpara kemi Programin Legjislativ i përgatitur nga Ministritë e linjes dhe miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ne si AKK duhet të caktojmë kryetarët për të marë pjesë në 13 Komisionet Parlamentare ku trajtohen Projekt-Ligjet që prekin fushën e autoriteteve lokale në Kosovës, derisa nëpër grupe punuese ndërministrore do të punojnë përfaqësuesit e Kolegjiumeve Profesionale të AKK-së. Përvoja e viteve paraprake shtoi kryetari Ismajli se kur në 83% të rasteve janë marrë parasysh kërkesat e AKK-së dhe ato janë inkorporuar në ligje të caktuara.

Kryetari i komunës së Prishtinës z.Shpënd Ahmeti kërkoi sqarime nga MAPL-ja pse në agjendën legjislative nuk është futur edhe Projekt-Ligji për Kryeqytetin, derisa Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së z.Besnik Osmani tha se kemi punuar në Dokumentin Konceptual lidhur me Projekt-Ligjin për Kryeqytetin dhe posa të miratohet ky dokument në Qeveri do të futet si pjesë e programit legjislativ për këtë vit.

Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim i tha se nga 99 Projekt-Ligje, AKK ka vlerësuar se duhet të merr pjesë në 31 Projekt-Ligje që kanë të bëjnë me komunat e Kosovës, derisa pritet të jenë edhe 15 Projekt-Ligje që do të përgatiten ndërkohë si ai për Tatimin në Pronë apo për Ushqimin, pastaj disa strategji nga Ministritë e linjës dhe akte tjera normative.

Pas diskutimeve edhe të kryetarëve të komunave z.Idriz Vehapi, z.Imri Ahmeti, z.Haki Rugova u vendos që të delegohen kryetarët nëpër Grupe Punuese sipas fushës së tyre profesionale në kohën kur arrijnë shkresat nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Kryetarët e Komunave përcaktojnë prioritetet e komunave për investime nga Komisioni Evropian

Në pikën tjetër të rendit të ditës, znj.Valbona Tahiri duke folur në emër të pesë Drejtorëve të Agjensive Rajonale të Zhvillimit (AZHR) paraqiti para kryetarëve të komunave prioritetet e përcaktuara nga AZHR-të për investime në komuna nga ana e Komisionit Evropian. Znj.Tahiri shtoi se AZHR në Veri ka përcaktuar prioritetet si: zhvillimi i një rajoni ekologjikisht të pranueshëm me shfrytëzim racional të burimeve natyrore, përmirësimi i mjedisit të biznesit konkurrues, zhvillimi i prodhimit dhe shërbimeve bujqësore dhe industrisë së përpunimit të ushqimit, forcimi i burimeve njerëzore dhe rritja e punësimit. Kurse AZHR në Lindje ka përcaktuar prioritetet si: zhvillimi ekonomik përfshirë infrastrukturën, zhvillimi i bujqësisë përfshirë infrastrukturën, zhvillimi i burimeve njerëzore dhe rritja e punësimit, bashkëpunimi dhe integrimi ndërkombëtar dhe ndër-rajonal, derisa ajo në Qendër ka përcaktuar prioritetet: përmirësimi i konkurrencës së bizneseve, rritja e punësimit dhe përmirësimi i fuqisë punëtore dhe përmirësimi i infrastrukturës, shërbimeve dhe mjedisit. Në anën tjetër AZHR në Jug është përcaktuar për: zhvillimin rural dhe bujqësisë, krijimi i ambientit të bizneseve të vogla dhe të mesme dhe zhvillimi i turizmit dhe në fund AZHR në Perëndim ka përcaktuar prioritetet për investime në: zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik me fokus turizmin, bujqësinë dhe përpunimi i ushqimit, zhvillimi i industrisë së përpunimit të drurit, zonat ekonomike, zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe aftësive profesionale, mbështetja e zhvillimit të infrastrukturës .

Këshilli i Kryetarëve pas diskutimeve njëzëri u dakordua që prioritetet e komunave që duhet të investohen nga Komisioni Evropian të jenë në harmoni me ato të AZHR-ve mirëpo të fuzionohen në: 1. Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm (zonat e biznesit dhe klima e të bërit biznes), 2. Bujqësia, turizmi dhe zhvillimi rural, dhe 3. Ekologjia (trajtimi i mbeturinave/ricikilimi, trajtimi i ujërave të zeza, parqet dhe efienca e energjisë).





Kryetari i Kuvendit priti udhëheqjen e AKK-së

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) z.Naim Ismajli dhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahimimi janë pritur sot në një takim pune nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës z.Kadri Veseli.

Udhëheqja e AKK-së ka njoftuar kryeparlamentarin Veseli për aktivitetet e Asociacionit për këtë vit, për synimet në sferën legjislative dhe për përfaqësimin sa më të mirë të interesave të autoriteteve lokale tek institucionet qendrore.

Poashtu është biseduar për fuqizimin e pjesëmarrjes së Asociacionit të Komunave të Kosovës në Komisionet Parlamentare sa i përket legjislacionit i cili prek kompetencat e komunave.

Në këtë drejtim Kryeparlamentari Veseli shprehu mbështetjen e tij të plotë dhe ka ofruar gatishmërinë për përkrahje në gjitha fushat që kanë të bëjë me avancimin e punës së autoriteteve lokale në Republikën e Kosovës.

Bashkëbiseduesit poashtu kanë debatuar edhe për mënyrat dhe format e bashkëpunimit mes Kuvendit të Kosovës dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe për funksionimin e sfidat e pushtetit lokal aktualisht në Kosovë.

Ministri i Financave u zotua se asnjë akt ligjor që ka implikime financiare për komnatat nuk do të procedohet pa konsultimin e AKK-së



Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) z.Naim Ismajli dhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahimimi janë pritur sot në një takim pune nga ministri i Ministrisë së Financave (MF) z.Avdullah Hoti. Udhëheqja e AKK-së ka njoftuar ministrin Hoti për aktivitetet dhe synimet për përfaqësimin sa më të mirë të interesave të autoriteteve lokale tek institucionet qendrore. Në këtë takim, udhëheqësit e AKK-së dhe të MF-së kanë biseduar edhe për programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës ku hyjnë edhe Projekt-Ligji për Financat Lokale dhe Projekt-Ligji për Tatimin në Pronë. Poashtu është biseduar për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Asociacionit të Komunave të Kosovës në Grupe e ndryshme Qeveritare, ku ministri Hoti ka shprehur mbështetjen e tij për këtë pjesëmarrje. Ministri i Financave z.Avdullah Hoti u zotua se asnjë akt ligjor dhe nënligjor që ka implikime financiare dhe buxhetore për komnatat nuk do të procedohet pa konsultimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës. Palët poashtu kanë debatuar edhe për format dhe mënyrat e bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Filloi implementimit i Projektit 'Skema BEACON'

Praktikat më të mira komunale në fushën e shërbimeve publike

Ju njoftojmë se Asociacioni i Komunave të Kosovës më mbështetjen financiare të GIZ filloj zbatimin e projektit 'Skema BEACON' / Praktikat më të mira komunale në fushën e shërbimeve publike. Me këtë rast në takimin e Kolegjiumit të Drejtorëve KOMunal për Shërbime Publike u lansua projekti i cili u mirëprit nga drejtorët komunal si një mundësi të afrimitit të projekteve dhe punëve komunale por edhe për të këmbyer përvojat e mira mes komunave.

Projekti 'Skema BEACON' synon përdorimin e tanishëm të praktikave/performancave më të mira të komunave të Kosovës duke i përhapur ato në komnatat tjera. Përveç kësaj, projekti ka tendencën të nxisë risi dhe të rrisë performancat aktuale të nivelit lokal.

Komnatat do të aplikojnë dhe seleksionimin do ta bëj një

Panel Këshillues i përbërë nga tre ekspertë të kësaj lëmie ndërsa projekti do të udhëheqet nga Bordi Drejtues prej tre kryetarëve të komunave.

Tre komnatat e para sipas vlerësimeve do të përfitojnë deri në 7000 euro për investime në fushën e shërbimeve publike në territorin e tyre.

Ceremonia e shpalljes së tri komunave të para me praktikat më të mira komunale në fushën e shërbimeve publike do të organizohet në fillim të muajit qershor.

Në muajin shtator, si vazhdimësi e projektit do të bëhet shpërndarja e praktikave më të mira tek komnatat tjera të Kosovës. Për formën dhe mënyrën e shkëmbimit të këtyre praktikave më të mira do të vendoset në muajt vijues dhe në varësi të implementimit të projektit.

Pas lobimit të AKK-së, amandamenti i Ligjit për Partneritetin Publiko Privat hyri në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2015

Sic jeni të informuar, Këshilli i Kryetarëve debatoi në takimin e fundit me datën 22 janar 2015 edhe lidhur me Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në këtë takim u miratua Lista e Draft Ligjeve në të cilat Asociacioni i Komunave të Kosovës do të merr pjesë në Grupe Punuese dhe do të lloboj për interesa të Komunave.

Në këtë takim u ngrit shqetësimi nga ana e kryetarëve për mungesën e amandamentimit të Ligjit për Partneritetin Publiko Privat në Programin Legjislativ për këtë vit dhe problemet që mund të kenë komunat në këtë fushë.

Asociacioni i Komunave të Kosovës filloi menjëherë angazhimin në këtë drejtim, dhe pas kërkesave e arsytimit për nevojën e amandamentimit të Ligjit për Partneritetin Publiko Privat e sidomos pas takimit që udhëheqja e AKK-së pati me ministrin e Ministrisë së Financave z.Avdullah Hoti është arritur që në Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2015 të hyj edhe amandamenti i Ligjit për Partneritetin Publiko Privat.

Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të AKK-së në Grupin Punues dhe në Komisionin përkatës Parlamentar shpresojmë të ndikojmë që gjatë këtij viti, Ligji i amandamentuar për Partneritetin Publiko Privat të jetë në shërbim dhe funksion të zhvillimit ekonomik në komunat e Republikës së Kosovës.



AKK-ja parandaloi zvogëlimin e të hyrave vetanake përfaqësuesit deri në 10 milion euro

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me një draft Rregullore kishte planifikuar heqjen e kushtëzimit për inkasimin e taksës vjetore motorike me pagesa tjera komunale, konkretisht pagesën e tatimit në pronë. Kësisoj, nëse do të hynte në fuqi kjo Rregullore, atëherë, sipas vlerësimeve të komunave, niveli i inkasimit të tatimit në pronë do të ulej ndjeshëm.

Mirëpo Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës në takimin që ka pasur me ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal z.Lubomir Mariq ka shprehur reagimin e komunave dhe ka kërkuar që të mos aprovohet kjo Rregullore. Pas këtij reagimi nuk është procesur më tutje ky dokument.

Vlen të ceket se sipas kësaj draft - Rregullore të planifikuar nga MAPL, inkasimi i taksës vjetore të automjeteve motorike nuk do të mund të kushtëzohej me pagesa tjera komunale, përveç në rastet kur automjeti motorik ndërron pronësinë. Prandaj në këtë mënyrë do të

ngushtohet edhe hapësira e komunave për investime në infrastrukturë dhe ofrim të shërbimeve efikase publike për qytetarët përmes vjeljes së tatimeve.

Gjithashtu, heqja e këtij kushtëzimi do të binte në kundërshtim me politikën e vendit që komunat të krijojnë qëndrueshmëri financiare. Vlen të theksohet se çdo vit inkasohet një shumë mjaft domethënëse nga komunat nga tatimi në pronë, ku vetëm vitin e kaluar janë inkasuar mbi 16 milionë ndërsa sipas përlllogaritjeve humbjet e komunave në rast zbatimi të kësaj Rregulloreje do të kalonte shumën prej 10 milion euro në vit.

Udhëheqja e AKK-së dhe MAPH-së dakordohen për bashkëpunim në fusha konkrete

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) z.Naim Ismajli dhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim janë pritur sot në një takim pune nga ministri i Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor MAPH) z.Ferid Agani.

Udhëheqja e AKK-së ka njoftuar ministrin Agani për aktivitetet dhe synimet për përfaqësimin sa më të mirë të interesave të autoriteteve lokale tek institucionet qendrore. Në këtë takim është debatuar në veçanti për trajtimin e ujërave të zeza si interes i veçantë i komunave ku Ministria është shprehur e gatshme për të financuar projekte në nivelin lokal si dhe për projektet për parandalimin e vërshimeve nëpër komuna.

Poashtu udhëheqja e AKK-së ka biseduar me ministrin Agani edhe për bashkëpunimin në hartimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore që dalin nga MAPH e që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale në Kosovë.



Bashkëbiseduesit kanë pajtuar që të formohet një grup punues i ekspertëve nga ana e Ministrisë dhe AKK-së për trajtimin e problemeve që po hasin komunat gjatë implementimit të ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Këshilli i Kryetarëve u takua nga ministri i ri i MASHT-it

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z.Arsim Bajrami ka prit-ur kryetarët e komunave në një takim informues pas marrjes së detyrës së tij. Në këtë takim ku ishin të pranishëm edhe drejtorët komunal për Arsim dhe përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, u bisedua për çështjet e sferës së arsimit në sistemin parauniversitar por edhe për mundësitë e bashkëpunimit mes dy niveleve të qeverisjes. Në këtë takim ministri Bajrami premtoi do ta bartë ndërtimin e shkollave të komunat, kurse MASHT-i do të merret me cilësinë e arsimit sepse 'kjo është ministri e arsimit dhe jo e ndërtimit' tha ai.



Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z.Arsim Bajrami në fjalën e tij tha se qeveria e re është në proces të konsolidimit, ne jemi në fazën e përgatitjes së programit qeveritar, i cili shpresoj që javën e ardhshme do të mund të vij edhe në parlament dhe unë si Ministër i Arsimit jam duke punuar afër me qeverinë për të hartuar edhe programin kombëtar të sferës së arsimit.

Vlerësojmë se tani pas përfundimit të agjendes shtetformuese dhe politike, ne duhet ti kthehemi realitetit jetësor, ku arsimi është një prioritet kombëtar dhe Qeveria e Republikës së Kosovës do të mund të fokusohet që përparimi në fushën e arsimit, shkencës dhe teknologjisë të jenë prioriteti i rëndësishëm kombëtarë.

Në mandatin tim, angazhimi kryesor në sferën e arsimit do të jetë ngritja e cilësisë së arsimit, cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies sepse vlerësoj se ne kemi punuar një kornizë të mirë ligjore, kemi hartuar strategji të mira politike, kemi bërë një decentralizim të nevojshëm në fushën e arsimit dhe fokusi ynë kryesor në këtë mandat do të jetë ngritja e cilësisë së arsimit.

Do të punojmë së bashku me Kryetarët e Komunave, së bashku me Drejtoritë Komunale të Arsimit shumë afër për të bashkëpunuar dhe kordinuar politikat tona qeveritare në sferën e arsimit. Arsimi parauniversitar në bazë të legjisllacionit për qeverisje lokale, legjisllacionit për arsimin është përgjegjësi e komunave, përgjegjësia ime si ministër është përgatitja e politikave të mira publike në sferën e arsimit, bashkëpunimi me ju në rishikimin eventual të kornizës ligjore sepse ju më së miri e dini se sa po implementohen këto

korniza ligjore në shkolla, aty ku ju qeverisni dhe menaxhoni, por mua më duhet një partneritet dhe një bashkëpunim i juaji i ngushtë sepse ne duhet të fillojmë nga autonomia e shkollës deri te niveli qendror, ku politikat e qeverisë do të jenë politikat e decentralizimit në sferën e arsimit. Kërkoj nga ju që të vendosim një bashkëpunim, do të takoj çdo muaj Drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit, është një praktikë e instaluar, por dëshiroj që të kemi edhe takime vjetore me kryetarët e komunave për të biseduar për problemet që i kemi në shkolla dhe në arsim dhe për të ndihmuar në rishikimin e politikave kombëtare në sferën e arsimit. Në mënyrë të veçantë kërkoj nga kryetarët e komunave që të mbështesin autonominë e shkollave, të ndihmojnë shkollat, nxënësit dhe arsimtarët, kurse nga kryetarët e qyteteve ku kemi edhe universitete të bashkëpunojmë me ato universitete që ato të konsolidohen sepse janë universitete të reja dhe kanë nevojë edhe për përkrahje të qeverisë qendrore edhe të qeverisë lokale.

Do ta bartë ndërtimin e shkollave të komunat. Kjo ministri do të jetë ministri e arsimit dhe jo e ndërtimit. Nuk do të shpenzojë kohë në ndërtimin e shkollave, do të shpenzojë kohë te ngritja e cilësisë në shkolla. Do ta kaloj qasjen te cilësia, te kualiteti i mësuesit, kualiteti i nxënësit, studentit që në këtë mënyrë do të reflektojë edhe te mirëqenia e familjes dhe e shoqërisë në përgjithësi.

Do t'iu bëj ftesë që ashtu siç po i mbështetni nxënësit në forma si shujta apo transporti, të keni pak mirëkuptim edhe për arsimtarët, për të cilët qeveria ka punuar shumë për t'iu krijuar të ardhura solide të cilat do të ngriten në pajtim me zhvillimin ekonomik dhe ngritjen e

përgjithshme ekonomike që të keni një përkujdesje ndaj mësimdhënësve në kompetencat që ju lejon edhe korniza ligjore për qeverisje lokale.

Ndërsa kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli pasi falenderoi për iniciativën për të takuar Kryetarët e Komunave tha që është hap i mirë se bashkarisht mund të dikutojnë çështjet më të rëndësishme. Besoj se edhe kryetarët tjerë një nga komponentat kryesore të punës e ka fushën e arsimit dhe mendoj se kjo është ajo pjesa e objektivit tonë të përbashkët me Ju. Do të jemi partnerë në kuptimin e zhvillimit dhe kontributit që mund ta japim në fushën e arsimit nga niveli i përgjegjësive që kemi ne. Jemi shumë të interesuar që të lëvizimim dhe të ndryshojmë segmentin e arsimit sikur që na inkurajon edhe qasja e juaj si ministër. Ne si komuna kaheerë kemi kërkuar dhe tashmë jemi të kënaqur që me ndërtimin e objekteve publike në sistemin e arsimit të merren komunat ashtu siç premtoi ministri Bajrami.

Në këtë takim diskutuan edhe kryetarja e Komunës së Gjakovës znj. Mimoza Kusari Lila , kryetari i komunës së Vushtrrisë z.Bajram Mulaku, nënkryetari i komunës së Suharekës z.Rexhep Kuçi, drejtoresha për Arsim në komunën e Prishtinës znj.Arbërie Nagavci, drejtori për Arsim në komunën e Gjilanit z.Nazmi Musa, kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës së Kosovës etj.

Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë u dakorduan të ketë takime periodike me kryetarët e komunave dhe ministrin Bajrami ndërsa takime mujore me Drejtorët Komunal për Arsim si pjesë e bashkëpunimit dhe koordinimit të obligimeve të secilit në fushën e arsimit.

Bordi i AKK-së mbajti takimin e rradhës me datën në 20 shkurt 2015, ku kryetari z.Naim Ismajli e kryesoi takimi dhe paraqiti para anëtarëve të Bordit rendin e ditës së takimit, i cili u miratua nga të pranishmit. Rendi i Ditës:

- 1. Aprovimi i Rendit të ditës – Naim Ismajli, Kryetar i AKK-së;**
- 2. Paraqitja e aktiviteteve të AKK-së për periudhën gjashtëmuajore;**
- 3. Projektet e AKK-së në vitin 2015;**
- 4. Pagesa e anëtarësisë dhe situata aktuale financiare e AKK-së dhe**
- 5. Të ndryshme.**

Në pikën e dytë rendit të ditës Drejtori Ekzekutiv z.Sazan Ibrahimimi paraqiti disa nga aktivitetet lobuese të Asociacionit të Komunave nga këtyre dy muajve të parë të 2015.

- Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës në takimin që ka pasur me ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal z.Lubomir Mariq ka shprehur reagimin e komunave lidhur me draft Rregulloren që kishte planifikuar heqjen e kushtëzimit për inkasimin e taksës vjetore motorike me pagesa tjera komunale, konkretisht pagesën e tatimit në pronë dhe ka kërkuar që të mos aprovohet kjo Rregullore. Pas këtij reagimi nuk është procesur më tutje ky dokument. Vlen të theksohet se çdo vit inkasohet një shumë mjaft domethënëse nga komunat nga tatimi në pronë, ku vetëm vitin e kaluar janë inkasuar mbi 16 milionë ndërsa sipas përlllogaritjeve humbjet e komunave në rast zbatimi të kësaj Rregullorje do të kalonte shumë prej 8 milion euro në vit.

- AKK-ja ka mbajtur një takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë lidhur me inspektorët e tregut dhe bartjen e kompetencave tek komunat dhe mbi të gjitha implementimin e ligjit në këtë aspekt. Lidhur me këtë do të bëhet një hulumtim për të vlerësuar arsyet e bartjes së kompetencave tek komunat lidhur me çështjen e inspektoratit të tregut.

- AKK-ja ka marrë mendimin e kryetarëve të Komunave lidhur me

Takimi i Bordit të AKK-së

vendimin e Qeverisë për themelimin e një Komisioni Ekzekutiv për shqyrtimin e mundësisë për faljen e borxheve të personave fizik dhe juridik, ndaj institucioneve shtetërore dhe ndaj ndërmarrjeve publike në Republikën e Kosovës, deri më 31 dhjetor 2008. Shumica e kryetarëve të komunave ishin 'pro' këtij vendimi. Mirëpo Kolegjiumi për Buxhet dhe Financa i AKK-së me këtë rast ka kërkuar që Qeveria e Kosovës ta kushtëzoj faljen e borxheve ndaj komunave me pagesën e një shume të caktuar të obligimeve të krijuara pas datës 31 dhjetor 2008.

- AKK-ja ka informuar kryetarët e komunave lidhur me procesin e plotësim-ndryshimit të Projektligjit për Ndërmarrjet Publike dhe AKK ka konsultuar Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe ndryshimet kanë të bëjnë me 5 nene të ligjit bazik për ndërmarrjet publike e të cilat nuk ndërlidhen me kompetencat e komunave sa i përket themelimit të ndërmarrjeve publike lokale. Pra, kryesisht ndryshimet kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe me ndërmarrjen shoqërore Trepça .

- Asociacioni i Komunave të Kosovës ka deleguar përfaqësuesit e vetë në grupet punuese në MASHT - z. Nexhmi Rudari për grupin punues lidhur me Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, - z. Besim Avdimetaj për grupin punues lidhur me Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, dhe - znj. Diana Qarkagjija për grupin punues lidhur me Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-018 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore.

- Poashtu AKK-ja ka deleguar tre përfaqësues në grupin punues për bashkëpunimin e organeve lokale dhe qendrore për zbatueshmërinë e ligjeve në fuqi në fushën e ndërtimeve dhe çështjeve tjera (z.Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së, z. Liburn

Aliu- Kryesues i Kolegjiumit të Planifikimit Hapësinor dhe z. Valon Shefkui- zv.kryesues i Kolegjiumit të Planifikimit Hapësinor.

Në pikën e tretë të Rendit të Ditës Drejtori Ekzekutiv z.Sazan Ibrahimimi elaboroi para Bordit edhe projektet që priten të realizohen gjatë vitit 2015. Drejtori Ibrahimimi potencoi projektin me GIZ-in "Beacon Scheme" lidhur me nxjerrjen dhe shpërblimin e praktikave të mira të komunave në fushën e menaxhimit të mbeturinave, pastaj vazhdimi i projektit me Agjencinë Zvicrane për Zhvillim SDC, projekti me GIZ-in lidhur me eficiencën e energjisë përmes (Open Regional Fund), projekti me Komisionin Evropian lidhur me përkrahjen e Agjensive Zhvillimore Rajonale dhe projekti me SDC-në lidhur me çështjen e ujit në komuna.

Bordi i AKK-së bisedoi edhe për situatën financiare ku u raportua se në vitin 2014 u inkasuan 136,564 euro nga 175,215 të planifikuara. Poashtu Bordi u informua me shpërndarjen e faturave për vitin 2015.

Në vazhdim Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës pas diskutimeve, vendosi që të bëjë disa ndryshime në stautin e AKK-së ku me këtë rast emëroi tre anëtar të Bordit, z.Naim Ismajli, z.Muharrem Sfarqa dh z.Agron Kuçi) për të përgatitur propozim ndryshimet dhe për t'ia paraqitur ato Kuvendit të AKK-së për shqyrtim. Në të njëjtën kohë lidhur me diskutimet dhe udhëheqjen e procesit për hartimin e Planit Strategjik të AKK-së 2016-2020 u emëruan z.Naim Ismajli, z.Muharrem Sfarqa dhe z.Agron Kuçi të cilët do të punojnë ngushtë me Kolegjiumet dhe stafin administrativ të AKK-së.

Bordi poashtu u dakordua që anëtarët e AKK-së në Komisionin e Granteve para takimeve në këtë komision të takohen me Bordin e AKK-së për të koordinuar qëndrimet për çështje të caktuara në këtë drejtim.

LAJME NGA KOMUNAT

Aksion për mbledhjen e mbeturinave të amvisërisë dhe atyre inerte

Komuna e Prishtinës, respektivisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Inspektionit nisi aksionin ku do të fillojë pastrimi i deponive ilegale në Komunën e Prishtinës të krijuara ndër vite. Pastrimi i mbeturinave të amvisërisë duhet të bëhet nga KRM "Pastrimi" si pjesë e kontratës për pastrimin e deponive që po bëhen pika mbledhëse të qenve endacakë, duke u shndërruar në pika të rrezikshme për qytetarët. Ndërsa, mbeturinat inerte do të largohen si pjesë e kontratave të pastrimit të mbeturinave inerte që Komuna e Prishtinës i ka me operatorë. Në këtë aksion do të ndihmojë edhe kompania publike lokale "Hortikultura". Po ashtu, pas pastrimit të mbeturinave të amvisërisë dhe atyre inerte, ftojmë të gjithë qytetarët të ndihmojnë së bashku në mirëmbajtjen e pastërishtë të qytetit. Komuna e Prishtinës është duke punuar sipas modelit të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave në Komunën tonë dhe gjatë javëve në vijim do të njoftoheni me të gjitha ndryshimet që do të ndodhin në Komunën e Prishtinës, sa i përket kësaj fushe. Gjithashtu, gjatë javës së ardhshme do të vendosen edhe tre kontejnerë të mëdhenj në tre pika të ndryshme në qytet me qëllim të largimit të mbeturinave të ndërtimit si dhe gjësëndeve të mëdha (p.sh. mobilie të vjetra).



Kryetari Velu e Haziri qëndruan për vizitë zyrtare në Gjermani



Kryetari i Komunës së Podujevës z. Agim Velu, dhe Kryetari i Gjilanit z. Lutfi Haziri qëndruan për vizitë zyrtare në Velbert të Gjermanisë. Në qytetin Velbert, kryetarët e Podujevës dhe Gjilanit, z. Agim Velu dhe z. Lutfi Haziri, janë pritur në Parlamentin e Nord Ëestfalen, ku kanë zhvilluar takim me deputetin e Landit z. Volker Munchof. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe z. Astrit Zemaj, konsull në Konsullatën e Republikës së

Kosovës në Frankfurt. Kryetari Velu falënderoi mikpritësit për pritjen e rezervuar për ta dhe shprehu dashamirësinë e tij për deputetin z. Volker Munchof, për të cilin tha se është një mik i mirë i qytetit të Podujevës.

"Shpresoj se rrugën e bashkëpunimit me qytetin e Velbertit që ka krijuar Podujeva do ta ndjek edhe Komuna e Gjilanit", tha kryetari Velu. Ndërsa, kryetari i Komunës së Gjilanit, z. Lutfi Haziri, tha se ndjehet i nderuar që po viziton Velbertin duke vlerësuar partneritetin në mes Podujevës dhe Velbertit. "Qytetarët kosovarë janë mirënjohës për gjithë ndihmën që ka dhënë dhe po jep Gjermani për vendin tonë", tha z. Haziri. Të dyja palët u deklaruan se thellimi i bashkëpunimit dhe rritja e përkrahjes nga shteti Gjerman për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, si dhe vazhdimi i përkrahjes në rrugën e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian do të ketë impakt direkt në ndaljen e migrimit ilegal.

Shkolla e mesme profesionale bëhet me klasën-model



Shkolla e Mesme Profesionale në Shtime, në bashkëpunim me Qendrën për Avancimin e Performancës së Arsimit (QAPA) në Prishtinë, kanë realizuar projektin që ka të bëjë me një klasë model, e cila do të shërbej për implementimin e projektit 'Gjithëpërfshirja Sociale në Arsimi dhe Aftësimi Profesional'. Ky projekt në vlerë prej 2500 euro është realizuar falë donatorit "Kultur Kontakt" nga Austria. Pajisja e kësaj klase model do të shkon në funksion të realizimit të objektivave të Projektit SIVET, gjithnjë duke e përkrahur edhe MASHT-in në zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse në shkollë, pastaj përkrahja e individualizimit në lëndët mësimore, zhvillimin e një kulture të shkollës dhe përfshirjen e mësimeve në program dhe trajnimin e akredituar nga Këshilli Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve (KSHLM).

"Kultur Kontakt" klasën model e ka pajisur me 30 karrige, 15 banka, 2 tavolina, 2 karrige lëvizëse, perde, vitrinë për vendosjen e librave, varëse për garderobë, 3 komplete librash për gjuhë angleze, 3 tabela të bardha, 2 harta, një tabelë për vendosjen e dokumenteve, një pano që identifikon klasën model, një varëse për projektor, një glob dhe mjete tjera konkretizimi.

Kryetari i AKK-së, njëherit zëvendëskryetar i NALAS-it, Naim Ismajli mori pjesë në Partners Forum të Vjenës

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), njëherit zëvendëskryetari i NALAS-it, Naim Ismajli, mori pjesë në Partners Forum (Forumi për Partneritet) në Vjenë të Austrisë, të organizuar nga Word Bank Group (Banka Botërore).



Në Forumin për Partneritet, temë e diskutimit ishin projektet që financohen nga Banka Botërore për planifikim urban, strategji antikorruptcion, efikasitet të energjisë dhe për menaxhim financiar, bëri të ditur kryetari Ismajli.

Kolegjiumet e AKK-së në periudhën Janar-Shkurt 2015

Sa i përket punës me 12 Kolegjiumet Profesionale të AKK-së në periudhën dymujore të këtij vitit është shënuar me një angazhim i shtuar dhe efikas. Në mënyrë të veçantë, ky impenjim është shoqëruar me hartimin dhe aprovimin e planeve të punës të të gjitha Kolegjiumeve të AKK për vitin 2015, duke u bazuar në planet strategjike afatmesme të Kolegjiumeve si dhe duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë, meqë puna e Kolegjiumeve është shumë e ndërlidhur me aprovimin e ligjeve në nivel të vendit. Gjatë punës me Kryesitë e Kolegjiumeve dhe me secilin Kolegjium veç e veç, në proces kanë qenë të involvuar edhe përfaqësuesit e organeve qendrore si MAPL, MF, MPMH, MASHT, etj., si dhe partnerët SDC, GIZ, projekti DEMOS, UN-Habitat, etj.

LAJME NGA KOMUNAT

Bashkëpunimi mes “Fondacioni Kosovë- Luksemburg” dhe komunës së Hanit të Elezit



Pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet komunës së Hanit të Elezit dhe “Fondacionit Kosovë- Luksemburg”, z.Hasanaj e njoftoi kryetarin Suma lidhur me objektivat konkrete të këtij projekti. Ai tha se përmes këtij fondacioni komunat do të përkrahen në tri fusha dhe atë të Arsimit, Zhvillimit Ekonomik si dhe në përkrahjen e komunitetit.

Sipas z.Hasanaj në sektorin e arsimit do të përqëndrohen në ngritjen e cilësisë së arsimit, do të mundësojë vazhdimin e shkollimit të nxënësve të privuar të shkollave të mesme veçanërisht vajzat, komunitetet si dhe nxënësve të zonave rurale. Në kuadër të këtij sektori do të investohet edhe në avancimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Në sektorin e përkrahjes së komunitetit, komunitetet e përzgjedhura do të ju ndihmohet në krijimin e një mje-

disi i cili mundëson përfshirjen e grupeve të marginalizuara, gratë të rinjët dhe pakicat për zbatimin e aktiviteteve të projektit në rritjen e perspektives së familjeve dhe individëve për të gjeneruar të ardhura.

Kryetari z.Refki Suma tha se komuna e Hanit të Elezit do të jetë partnere shumë serioze në implementimin e projektit të Fondacionit Kosovë- Luksemburg duke u zotuar se do të participojë në formë të bashkë-investimit në të gjitha komponentet e projektit për të cilë do të dakordohemi.

FERIZAJ

Gjatë këtij viti do të jenë gati planet urbane për të gjitha zonat e qytetit

Bazuar në statistikat që ka prezantuar Drejtorja e Urbanizimit, deri më tani në komunën e Ferizajt janë regjistruar mbi dhjetë mijë objekte të ndërtruara pa leje. Gjatë këtij viti kjo drejtori do të përmbyllë edhe fazën e hartimit të planeve detale urbane për tetë zonat e qytetit, në të cilat do të përshihen edhe kërkesat e qytetarëve por edhe të kompanive të ndërtimit.

Drejtori Grainca ka vë në dukje se kjo drejtori ka avancuar edhe me planet urbane për zonat e qytetit. Sipas tij, gjatë këtij muaji pritet që të miratohet plani i reviduar urban për zonën e parë dhe zonën e tetë.

Ndryshe, u bë e ditur se komuna e Ferizajt, do nis edhe projektin e hartimit të planeve urbane edhe për zonat rurale, për faktin se nga momenti kur ka hyrë në fuqi Ligji i legalizimeve edhe në zonat rurale ndërtuesit duhet t'i nënshtrohen ligjit të ndërtimit dhe të pajisen me leje.

Vjelja e Detyruar e Tatimit në Pronë nga ana e Komunave



Punëtorja mbi "Zbatimin e Praktikave dhe Mjeteve të Komunave për Përmirësimin e Vjeljes së Detyruar të Tatimit në Pronë" u organizua nga projekti DEMOS në Prishtinë. Qëllimi i punëtorisë ishte mbledhja e akterëve kyç për të diskutuar praktikën nga komunat për rritjen e inkasimit të të hyrave nga tatimi në pronë përmes vjeljes së detyruar. Panelistët e punëtorisë ishin përfaqësues nga Komunat për Buxhet dhe Financa, Departamenti i Tatimit në Pronë pranë Ministrisë së Financave, Banka Qendrore e Kosovës, Shoqata e Bankave dhe USAID.

Punëtorja trajtoi tema kyçe, duke përfshirë (a) kornizën ligjore dhe rolin e Ministrisë së Financave në mbështetjen e vjeljes së tatimit në pronë; (b) praktikën komunale të vjeljes së detyruar të tatimit në pronë; (c) rishikimin e mjeteve juridike dhe administrative për vjeljen e tatimit në pronë; (d) përmirësimin e bashkëpunimit dhe thjeshtësimin e procedurave me sek-

torin bankar; (e) si dhe rolin e përmbarimit privat në vjeljen e tatimit në pronë. Diskutimet gjatë punëtorisë nxorën nevojën për një kuadër të tërë përmirësimesh:

- Përmirësimin e planifikimit buxhetor duke buxhetuar nivelin e vjeljes së tatimit në pronë më lartë se shumica e faturuar (për shkak të vjeljeve të borxheve të grumbulluara);

- Përmirësimin e menaxhimit të tatimit në pronë, duke instaluar një sistem të përkujtimit të borxhit në mënyrë sistematike përmes telefonit dhe vizitave personale;

- Ndërmarrja e masave nxitëse, p.sh.: përfshirja e konkursit publik për tatimin në pronë, ku lagjeve me shkallën më të lartë të vjeljes i dhurohen fonde për investime kapitale, i cili do të shpenzohej sipas prioriteteve të lagjeve. Kjo kërkon një qasje pro-aktive të komunave në analizimin e të dhënave mbi vjeljen e tatimit në pronë dhe monitorimin e procesit të vjeljes gjatë

gjithë vitin në raportet e menaxhimit;

- Ndërmarrja e masave të kushtëzimit, duke përfshirë nxjerrjen e një rregulloreje të brendshme komunale për vendosjen e standardeve për kushtëzimin e shërbimeve me pagesën e tatimit në pronë, duke e botuar dhe aplikuar barabartë dhe njësoj tek të gjithë tatimpaguesit. Sugjerimet shtesë sugjerojnë nivelet e kushtëzimit të pagesave të borxheve me nivele më të larta të kushteve për shërbime luksoze, siç janë regjistrimet e pronës;

- Ndërmarrja e vjeljes së detyruar, duke përfshirë (a) bllokimin e drejtpërdrejt të llogarive bankare dhe qasje tek debitorët për arritjen e marrëveshjeve për debitim të drejtpërdrejt me një plan specifik mujor të pagesës së tatimit në prone; (b) unifikimin e të gjitha praktikave të komunave sa i përket vjeljes së detyruar të tatimit në pronë nëpërmjet llogarive bankare, në bashkëpunim të ngushtë me bankat komerciale, mundësisht nëpërmjet Shoqatës së Bankave të Kosovës; (c) përdorimin e përmbaruesve privat, për vjeljen më të shpejtë të detyrimeve tatimore; (d) fillimin e diskutimeve me BQK-në për qasjen e mundshme në qendrën e inventarit të llogarive bankare (për banka dhe komuna).

- Përmirësimin e vjeljes nga (ish) ndër-marrjet shoqërore, duke arritur marrëveshje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit që përcakton një plan dinamik për vjeljen e borxheve të tatimit në pronë.

Komuna e Gjakovës dhe e Kaçanikut fillojnë procesin e hartimit të planit për menaxhim të mbeturinave

Grupet punuese në Komunën e Gjakovës dhe atë të Kaçanikut, me përkrahjen e projektit DEMOS, kanë filluar punën rreth hartimit të planit për menaxhim të mbeturinave për një periudhë pesë vjeçare. Këto grupe i kanë mbledhur të dhënat bazë të cilat shërbejnë për analizën e gjendjes ekzistuese dhe për llogaritjen e kostos operative të ofrimit të shërbimeve. Hapi i ardhshëm do të jetë përcaktimi i standardeve të shërbimit dhe investimet e nevojshme bazuar në nevojat dhe mundësitë e këtyre komunave dhe qytetarëve të tyre. Pjesë e këtij procesi do të jetë edhe vendosja e një politike për përcaktimin e tarifave dhe e mekanizmave për inkasim, si dhe përzgjedhja e modelit të operatorit, sipas legjislacionit në fuqi.

I gjithë ky proces do të përcillet me konsultime të vazhdueshme të akterëve relevantë për t'i përfshirë nevojat e tyre dhe për të siguruar mbështetjen e nevojshme për zbatimin e këtyre planeve. Për projektin DEMOS, është shumë me rëndësi që i gjithë ky proces udhëhiqet nga zyrtarët komunalë duke qenë se janë këta zyrtarë ata të cilët duhet të sigurojnë zbatimin e planit në vitet e ardhshme.






Kush jemi ne?

Programi i GIZ-së për Shërbimet e Qëndrueshme Komunale (SMS), i cili realizohet në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (BMZ), u ndihmon komunës së Prishtinës, Gjilanit, Pejës, Mitrovicës Jugore dhe Drenasit që t'i avancojnë shërbimet që u ofrohen qytetarëve. Megjithatë, SMS-i bashkëpunon ngushtë me Programin DEMOS, i cili financohet nga qeveria zvicerane, në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe i përmbahet një qasjeje rajonale në disa fusha të reformës. Kështu, së bashku ne e arrijmë pothuaj 70% të popullsisë së Kosovës (shih hartën). Për përmirësimin e qëndrueshëm të shërbimeve, ne i mbështetim komunat në dy fusha kryesore: në menaxhimin e mbeturinave të ngurta (MMN) dhe në reformat administrative. Në të parën, komunat përballen me kompani rajonale të mbeturinave jo efektive, shkallë të ultë të inkasimit dhe kurrfarë planifikimi për atë si të trajtohen sfidat e mëdha mjedisore në qytetet e tyre. Kështu, ne u ndihmojmë këtyre komunave që ta krijojnë një sistem pjesëmarrës të MMN-së, që t'i llogaritin shpenzimet, që të hartojnë politika tarifore dhe që eventualisht të vënë në funksion mekanizma të rinj për inkasim për t'i shtuar të ardhurat. Veç kësaj, ne e mbështetim ndryshimin e modelit të operatorit të MN-ve – do të thotë për ta reformuar mënyrën se si bashkëveprojnë komunat dhe ndërmarrjet publike p.sh. përmes vënies në zbatim të marrëveshjeve për shërbime dhe vlerësim-it të performancës apo duke i modernizuar procedurat

administrative. Megjithatë, kryetarët e komunave duan të shohin rezultate të dukshme për qytetarët e tyre, kështu që ne i mbështetim komunat që të bëjnë ndryshime të dukshme, siç është fillimi i mbledhjes së ndarë të mbeturinave në më shumë se 60 shkolla, zgjerimi i shërbimeve të mbeturinave, riorganizimi i mbledhjes në qendrat e qyteteve dhe fillimi i mbledhjes së ndarë të mbeturinave në pilot lagje. Së bashku ne mund ta pastrojmë Kosovën!



Vizitë nga Komunitat e Kosovës me qëllim marrjen e eksperiencës në fushën e menaxhimit të mbeturinave

Përfaqësues nga komunat e Mitrovicës, Pejës, Gjilanit dhe Drenasit realizuan një vizitë zyrtare ku qëllimi kryesor ishte shkëmbimi i eksperiencës në fushën e menaxhimit të mbeturinave, fushë në të cilën Bashkia Lezhë ka kohë që po operon suksesshëm. Bashkia Lezhë prej më shumë se 4 vitesh po aplikon sistemin e grumbullimit të mbeturinave në mënyrë të diferencuar.

Në mbështetje të këtij projekti nga Instituti i Kërkimeve Urbane, u mundësua projekti i grumbullimit të plastikës në mënyrë të diferencuar. Aktiviteti kryesor i këtij projekti ka qenë sensibilizimi i opinionit qytetar, për të bërë ndarjen që në burim. Pikërisht për të shpjeguar këtë proces hap pas hapi, z. Edlir Vokopola – Drejtor në Drejtorinë së Planifikimit dhe Zhvillimit në Institutin e Kërkimeve Urbane, realizoi një prezantim nga i cili përfaqësuesit nga Kosova morën eksperiencën e duhur për të realizuar një proces të ngjashëm në Komunat e tyre.



Shkëmbimi i përvojave rreth menaxhimit të mbeturinave rreth ndarjes, riciklimit apo edhe të ndezjes së tyre për prodhim të energjisë, janë gjithmonë të mirëseardhura për një ambient sa më të pastër – Blerim Baruti

Shkëmbimi i përvojave rreth menaxhimit të mbeturinave rreth ndarjes, riciklimit apo edhe të ndezjes së tyre për prodhim të energjisë, janë gjithmonë të mirëseardhura për një ambient sa më të pastër – Blerim Baruti

Shkurtimisht

- Disa prej ministrive, kanë filluar me formimin e grupeve punuese për hartimin apo plotësim-ndryshimin e projektligjeve dhe AKK-ja është anëtare ne ato grupe punuese.
- AKK-ja është anëtare në grupin punues për hartimin e Planit të veprimit për Turizëm në Kosovë, i cili dokument iu shpërndarë të gjitha komunave për të dhënë vërejtjet apo plotësimet e tyre.
- AKK-ja ka filluar takimet me Komisionet Parlamentare dhe Administratën e Kuvendit për të vazhduar bashkëpunimin sa i përket takimeve të Komisioneve Parlamentare, kur shqyrtohen projektligjet që ndërlidhen me kompetencat dhe detyrat e autoriteteve lokale.
- AKK-ja është anëtare në Këshillin Organizativ për organizimin e Ditës Botërore të Ujit- 22 mars dhe Ditës Botërore të Meteorologjisë – 23 mars.

LADDER: 'Autoritetet Lokale si Drejtues për Zhvillimin e Arsimit dhe Ngritjen e Vetëdijes'



Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në këtë ngjarje tre-ditore që u zhvillua në Modena, Itali nga 20 deri 22 Shkurt, në kuadër të projektit LADDER, ku u fokusua në sfidat që lidhen me Vitin Evropian të Zhvillimit 2015, dhe edicioni i VIII i BukFestival, i drejtuar nga Francesco Zarzana. Në këtë rast, AKK-ja është bashkëpunëtor (associate) i projektit LADDER.

Në ditën e parë, të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët u takuan gjatë takimit wordcafé, për të ndarë idetë, pritjet dhe përvojat, dhe të fillojnë të gjithë së bashku aventurën e madhe tre

vjeçare të projektit LADDER. Ky ishte rasti për të gjithë 26 partnerët dhe 20 bashkëpunëtorët për t'u njohur me njëri-tjetrin më mirë dhe të përgatiten për bashkëpunim.

Në ditën e dytë, të gjithë pjesëmarrësit morën pjesë në Komitetin Drejtues të parë të partnerëve të projektit "LADDER – Autoritetet Lokale si Drejtues për Zhvillimin e Arsimit dhe Ngritjen e Vetëdijes", për të diskutuar rreth aspekteve kryesore të tij dhe për rolin që partnerët dhe bashkëpunëtorët do të kenë.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS BULETINI

Viti XII. Nr. 70 • Janar - Shkurt 2015
PËRGATITI: Arsim Osmani

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacioni i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

